

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“AUTO TRANSPORTI - DURRES “ SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më datë 11.12.2019, une i nenshkruari:

1. **Agim Nina**, i datëlindjes 05.08.1974, banues ne Durres, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi H40805069N

themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

**“AUTO TRANSPORTI - DURRES “ SHPK**

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

**Neni 2: Selia**

**Lagjja nr. 3, Rruga Egnatia, Pallati 1017, Durres**

Shoqeria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

### **Neni 3: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Transport nderkombetar e kombetar mallrash e udhetaresh per te trete dhe me qira.
- Agjensi transporti udhetaresh e mallrash.
- Shoqëri spedicionere, shërbime spedicionere dhe transporti mallrash të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për vete dhe për të tretë
- Dhenie dhe marrje mjete me qera, asete, pasuri te paluajtshme etj.
- Import – Eksport, tregtim me shumice dhe pakice te mallrave industriale, ushqimore, veshmbathje, materiale te ndertimit, automjetesh e pjese kembimi per to, makinerish e pajisje, elektroshtepiakeve, hidrosanitare, elektrike e elektronike, mobilje, kozmetike, bime medicinale, hidrosanitare, etj
- Shoqëria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 te Ligjit nr.9901,dt.14.04-08).

### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është **100.000 (njëqindmije)** Lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**Agim NINA**, është zotërues i 1 kuote, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 100.000 leke.

#### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Agim NINA**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

#### **Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakeve të Shoqërisë

**Agim NINA**

